



BASHKIA SKRAPAR

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Punë

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: Punime të sinjalistikës horizontale dhe vertikale si dhe element të mobilimit urban, në rrugët e qytetit, Bashkia Skrapar

LLOJI I PROCEDURËS: E HAPUR, E THJESHTUAR

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 34992200-9

VLERA E FONDIT LIMIT: 4 632 850 (katërmilion e gjashtëqind e tridhjetë e dymijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë **pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Skrapar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore për xhiron vjetore për 3 vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se **40%** e vlerës së përlllogaritur të fondit limit të

objektit të prokurimit. *Për plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga dega e Tatim-Taksave ose vërtetim elektronik nga shërbimet e-Albania.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe pika 1 dhe pika 2, gërma b) dhe pika 3, të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, pika 1, të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 Për Tatimin mbi të Ardhurat, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Çdo tatimpagues përparatit deklaraten vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.”*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare, 2021, 2022, 2023, që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në 2 bilancet e njëpënjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: “c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shumën e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 39, 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Njësia e prokurimit e vlerëson të nevojshme kriterin për xhiron mesatare, dorëzimin e dokumentit përkatës vërtetimi ose pasqyrat financiare vjetore, pasi vërtetojnë kapacitetet ekonomike, financiare të operatorit ekonomik me qëllim përmbushjen dhe realizimin e kontratës. Kapaciteti pozitiv financiar i operatorit i dokumentuar me bilanc apo pasqyra financiare për tre vite buxhetore i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatoreve ekonomikë dhe të mundësisë se tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Pasqyrat financiare me bilanc pozitiv dhe gjendja financiare bankare paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar të operatorit ekonomik.

2.2.3 Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga Njësitë e Qeverisjes Vendore që nuk kanë detyrime të pashlyera për vitin 2022 dhe 2023. Ky vërtetim kërkohet për Njësinë Vendore ku Operatori Ekonomik ka të rregjistruar selinë qendrore, si dhe për të gjitha Njësitë Vendore ku Operatori Ekonomik ka ushtruar aktivitet gjatë këtyre dy viteve.

***Shënim :** Operatorët ekonomikë për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për detyrimet e maturuara për vitin 2023. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK*

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon:

1. vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve, si dhe:
 2. Situacionin përfundimtar të objektit;
 3. Akt kolaudimi objekti;
 4. Çertifikaten e marrjes ne dorezim te objektit
-

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi:

1. vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, si dhe:
2. Situacionin përfundimtar të objektit;
3. Aktin e kolaudimit;
4. Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, pika 2.3.1 gërma a), plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2 Licenca profesionale

Operatori ekonomik ofertues, duhet të zotërojë licencë profesionale në fushën e zbatimit të punimeve në ndërtim, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore , e cila të përmbajë kategoritë si më poshtë:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

N.P – 1 A Punime gërmimi në tokë.

PUNIME SPECIALE NË NDËRTIM

N.S -6 A Sinjalistika rrugore jondriçuese

Analiza	Argumentimit i analizës	Niveli i shoqërisë	Argumentimi i nivelit të licencës sipas VKM.42
N.P. 1	Përshkrimi në VKM 42: <i>Konsiderohen gërmimet, sistemit dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore. Zërat e punimeve në preventiv: F.v. Tabela trekendore normal me A = 90 dhe F.V. Tabela të ndryshme rrugore D = 60cm, sipas projektit dhe specifikimeve teknike përfshijnë: gërmim grope 50x50cm për vendosjen e tubit të tabelës. Në këtë kuptim: Licenca N.P.1 është e nevojshme</i>	A	Niveli A i licencës pasi punimet e parashikuara janë më pak se 20 milion lekë

N.S.- 6	Përshkrimi në VKM 42: <i>Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jondriçuese, vertikale, horizontale dhe komplementare. Punimet në preventiv janë sinjalistikë jondriçuese, horizontale, vertikale dhe komplementare.</i>	A	Niveli A i licencës pasi punimet e parashikuara në preventiv janë më pak se 20 milion lekë
---------	--	---	--

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kritere të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane..", VKM-së nr.759/2014 "Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim". Licencat janë të lidhura ngushtësisht me punimet e ndërtimit dhe projektin e zbatimit dhe Ligjit nr.10081 date 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar. Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet

2.3.3 Stafi dhe punonjësit

- A. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtoare minimalisht jo me pak se **9 (nëntë)** punonjës. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën **3 muajt e fundit**, (Maj, Qershor, Korrik), në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, **sipas shtojcës nr. 8. Ndërsa operatori ekonomik fitues, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë:**
- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën 3 muajt e fundit
 - Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën 3 muajt e fundit.

Argumentimi: Bazuar në ligjin. nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 79 dhe neni 77 pika 4, në të cilin thuhet: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.”, si dhe të VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 44 pika 1, AK kërkon cilësi dhe garanci të

mallrave duke qenë se këto mallra do të përdoren në objekte arsimore dhe koha e përdorimit të tyre duhet të jetë jo e shkurtër. Ky kriter është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminues për operatorët.

Shënim: Çertifikatat e mësipërme/ekuivalente duhet të jenë të lëshuar nga Institucione të çertifikuara/akredituara në Shqipëri ose tek ato ndërkombëtare dhe në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë keto certifikata në perputhje me shërbimet/mallrat që ka marrë përsipër në marreveshjen e bashkëpunimit.

B. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- **Inxhinier me licencë profesionale 11. a) dhe 11. b)** 1 (një)

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.** Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqitet:

- *Të figurojë si komponent i listës së personelit kryesor.*
- *Licencën personale profesionale.*
- *Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi, në listëpagesat e tre muajëve të fundit që janë kërkuar më lartë.*

C. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar punonjës të kualifikuar si më poshtë:

- a) **Drejtues të automjeteve të rënda (Kat C)** 1 (një)

Për drejtuesit e automjeteve të rënda, të paraqitet:

- Kontratë individuale pune e vlefshme , për periudhën e parashikuar të realizimit të punimeve.
- Leje Drejtimi kategoria të paktën C
- Certifikatë Aftësimi Profesional nga DPSHTRR
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë

b) Punonjës “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë 1(një)

STAFI DREJTUES TEKNIK (në licencën e subjektit)	Argumentimi
<p>Inxhinier me licencë personale 11. a) dhe 11. b) i cili mund të jetë: Inxhinier Ndërtimi në Infrastrukturë e Transportit/në profilin e Inxhinierit Mekanik në Infrastrukturë e Transport ose në Planifikimin e Sistemeve të Transportit, Trafikut e Sigurisë Rrugore</p>	<p>Sipas kategorisë së licencës të kërkuar për subjektin N.S.-6 "Sinjalistika rrugore jondriçuese" dhe sipas përcaktimeve në V.K.M. nr. 943, datë 28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014,"Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim". lidhja 4, pika 11. PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR</p>

DREJTUES KAMIONI	Argumentimi
Drejtues kamioni (autokamionist) me Leje drejtimi të paktën të tipi C si dhe të pajisur me Certifikatë Aftësimi Profesional nga DPSHTRR	Për drejtimin e kamionit me vinç, të kërkuar te "Makinertë dhe paisjet"

Argumentimi: Kërkesa është bazuar në pikën 4 të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 39, pika 6, shkronja c dhe ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku ky kriter lidhet ngushtësisht me objektin të kontratës *si dhe në përputhje me zërat dhe afatin e punimeve të parashikuara në preventivin dhe grafikun e punimeve*. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Numri i stafit kryesor teknik si numri një i inxhinierëve sipas profilit, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës dhe i bazuar në ligj, me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mire në kryerjen e punimeve, duke ju referuar objektit, vendndodhjes gjeografike. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast mund të çojë në mosrealizim në afat dhe me cilësi të dobët të punimeve. Personeli teknik i inxhinierëve, kapacitetet dhe aftësitë organizative janë të domosdoshëm për realizimin të kontratës

2.3.4 Mjetet dhe paisjet

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë mjetet dhe paisjet e nevojshme për realizimin në kohë dhe me sukses të punimeve, si më poshtë:

	Paisje e makineri	Njësia	Sasia	Pronësia
1	Makineri vijëzimi me spërkatës boje bikomponente për vizime në rrugë	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Semafor portativ për menaxhimin e trafiku (për dy senset e rrugës)	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Betoniere kantieri	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Matrapik	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Gjenerator motor	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Kamion me Vinç	copë	1	Në pronësi ose me qera

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, **sipas shtojcës nr. 8.** “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

(a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:

- dokumentacioni që verteton rregjistrimin e mjetit leja e qarkullimit;
- çertifikatën e kontrollit teknik;
- siguracionin;
- leja e transportit e vlefshme
- foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij;

(b) Për mjetet e mara me qira, krahas dokumentacionit të kërkuar në pikën a), duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e noterizuar e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës.

- (c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse dhe fotot.
- (d) Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- (e) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Paisje e makineri	Argumentim për zërat e punës në preventiv
Makineri vijëzimi me spërkatës boje bikomponente për vizime në rrugë	Vijëzim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 12 cm. Bikomponente (sprajt)
Semafor portativ për menaxhimin e trafikut (për dy senset e rrugës)	Për menaxhimin e trafikut dhe sigurinë rrugore gjatë kryerjes së punimeve në karrexhatën e rrugës
Betoniere kantieri	Zërat e punimeve në preventiv: F.v. Tabela trekendore normal me A = 90 dhe F.V. Tabela të ndryshme rrugore D = 60cm, sipas projektit dhe specifikimeve teknike përfshijnë: gërmim grope 50x50cm dhe betonim të tubit të tabelës. Në këtë kuptim: 1. betoniereja duhet për betonin; 2. matrapiku për thyerjen e shtresës së trotuarit; 3. gjeneratori për matrapikun etj.
Matrapik	
Gjenerator motor	
Kamion me Vinç	Për transportin e paisjeve të ndërtimit dhe materialeve ndërtimore

Argumentimi: Kërkesa është bazuar në pikën 4 të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", dhe nenit 39, pika 6, shkronja d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Kriteri është në përputhje me zërat dhe afatin e punimeve të parashikuara në preventivin dhe grafikun e punimeve. Gjithashtu është në përputhje me natyrën, zërat e punimeve dhe vlerën e kontratës. Operatorët ekonomik kërkesat për pajisjet në pronësi, mund ti plotësojnë edhe duke i marrë ato me qira. Lidhur me paisjet Autoriteti Kontraktor ka patur parasysh projektin, preventivin dhe relacionin teknik. Këto paisje mund të sigurohen lehtësisht nga operatori ekonomik pasi janë me kosto relativisht të ulët dhe nuk përbëjnë kriter diskriminues

2.3.5 Kërkesat e cilësisë

A. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të vlefshme për periudhën e ndërtimit, si më poshtë, ose ekuivalente me to:

- ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) (ose ekuivalente)
- ISO 45001-2018 (Siguria dhe shëndeti në punë) (ose ekuivalente)

Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë këto certifikata (ose ekuivalente), në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

- B.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar për materialet e ndërtimit: 1. Bojë bikomponente; 2. Sinjalistikën vertikale dhe 3. Ngadalësues shpejtësie (kurrizet artificiale). Në rast se paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja ndërmjet distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.
- C.** Operatori ekonomik për materialet e ndërtimit: 1. Bojë bikomponente; 2. Sinjalistikën vertikale dhe 3. Ngadalësues shpejtësie (kurrizet artificiale). duhet të paraqesë, katalogun dhe/ose skedat teknike, të shoqëruara me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe, (nëse janë në gjuhë të huaj) të botuara nën autoritetin e prodhuesit, që nënkupton se duhet të jenë me logon e tij dhe ku jepen të gjitha karakteristikat teknike të këtyre materialeve me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.

Argumentimi: Bazuar në ligjin. nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 79 dhe neni 77 pika 4, në të cilin thuhet: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.”, si dhe të VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 44 pika 1 dhe 2, AK kërkon cilësi dhe garanci të punimeve duke qenë se objekti është i një rëndësie të veçantë. Ky kriter është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminues për operatorët.

Shënim: Çertifikatat e mesiperme/ekuivalente duhet të jene të leshuar nga Institucione të certifikuar/akredituara në Shqipëri ose tek ato nderkombetare dhe në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këto certifikata në përputhje me shërbimet që ka marre persiper në marreveshjen e bashkepunimit.

3. TË PËRGJITHSHME

Pavarësisht sa përcaktohet në pikën 1 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit”, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në pikën 2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit” dhe të paraqitura nga ofertuesi në formularin përmbledhës të deklaramit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Specifikimet Teknike

Objekti i prokurimit: *"Punime të sinjalistikës horizontale dhe vertikale si dhe element të mobilitetit urban në rrugët e qytetit Çorovodë, Bashkia Skrapar"*, shoqërohet me projekt zbatimi të plotë, specifikime teknike, grafik punimesh dhe preventiv punimesh.

Specifikimet teknike, në një dokument prej 19 faqesh, sqarojnë të gjitha kërkesat e projektit për materialet, mënyrën e kryerjes së punimeve etj. Ato përmbajnë kapitujt dhe nënkapitujt si më poshtë.

1.	<u>SINJALISTIKA</u>
1.1	<u>Hyrje</u>
1.2	<u>Sinjalistika rrugore horizontale</u>
1.2.1	<u>Të përgjithshme</u>
1.2.2	<u>Ngjyrat dhe boja</u>
1.2.3	<u>Shirita të ndarjes së drejtimeve të lëvizjes</u>
1.2.4	<u>Shiritat e korsisë</u>
1.2.5	<u>Shiritat anësorë të rrugës</u>
1.2.6	<u>Metoda e realizimit të vijëzimit të rrugës</u>
1.2.7	<u>Cilësia e realizimit të punimeve</u>
1.2.8	<u>Makina/t për realizimin e vijëzimit në rrugë</u>
1.2.9	<u>Kontrolli i cilësisë</u>
1.3	<u>Sinjalistika rrugore vertikale</u>
1.3.1	<u>Të përgjithshme</u>
1.3.2	<u>Dukshmëria e sinjaleve</u>
1.3.3	<u>Vendosja</u>
1.3.4	<u>Tabela rreziku apo lajmëruese të cilat do të përdoren në projekt</u>
1.3.5	<u>Materiali</u>
1.3.6	<u>Garancia e materialeve</u>
1.3.7	<u>Certifikatat e garancisë</u>
1.4	<u>Kalimet e këmbësorëve</u>
1.5	<u>Ngadalësuesit e shpejtësisë</u>
3.	<u>ELEMENT URBAN</u>

Specifikimet Teknike do të jepen bashkëlidhur Dokumenteve Standarte te Tenderit, për procedurën e hapur të thjeshtuar, punë.

Për pasojë, kërkesa e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 36 “Specifikimet teknike”, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 neni 2 “Dokumentimi i Procesit”, pika 2 gërma c), dhe neni

78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, lidhur me hartimin e specifikimeve teknike, konsiderohet e plotësuar.

Përfundime

Me miratimin e kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit, kriterëve të vlerësimit, si dhe specifikimeve teknike, njësia e Prokurimit miraton Dokumentet Standarte të Tenderit, për procedurën e hapur të thjeshtuar, punë me objekt prokurimi *"Punime të sinjalistikës horizontale dhe vertikale si dhe element të mobilimit urban në rrugët e qytetit Çorovodë, Bashkia Skrapar"*.

Personi përgjegjës i prokurimit, pjesë e njësisë së prokurimit, të bëjë publikimin e procedurës në Sistemin e prokurimit elektronik, në faqen e APP-së

NJËSIA E PROKURIMIT

Altin Lamçe

Ernest Ymeri

Florand Osmani
